

SKEDA E GJYKIMIT NË TRE SHKALLË

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë prej:

Ardian DVORANI	- Kryesues
Arjana FULLANI	- Anëtar
Evelina QIRJAKO	- Anëtar
Andi ÇELIKU	- Anëtar
Medi BICI	- Anëtar

në datën 29.03.2016, në dhomë këshillimi, mori në shqyrtim çështjen administrative me nr. 02861/2013 akti, që u përket palëve:

PADITËS: **Robert Martini**, në mungesë. **Bubulina Martini**, në mungesë

PALË E PADITUR: **Ministria e Punëve të Jashtme**, përfaqësuar në gjykim nga Znj. Etleva Haka, në mungesë në shpalljen e vendimit.

OBJEKTI: Detyrimin e palës së paditur të na paguajë pagën në lidhje me afatin e njoftimit. Detyrimin e të paditurit të na paguajë: dëmshpërblimin për zgjidhjen në mënyrë të njëanshme, të pajustificuar të kontratës së punës, dëmshpërblimin për moszbatim procedure të pushimit nga puna, shpërblimin për vjetërsinë në punë, pushimet vjetore të pakonsumuar për vitet 2009–2011; Detyrimin e të paditurit për të na paguar shpenzimet e banimit në Republikën e Malit të Zi për shkak të ushtrimit të detyrës; Detyrimin e të paditurit të derdhë kontributin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për periudhën tetor 2010 – shkurt 2011.

BAZA LIGJORE: Neni 153 i K.Pr.Civile; nenet 94, 126/1, 141, 143,144, 145, 152, 155 të Ligjit nr. 7971, datë 12.07.1995 “Për Kodin e Punës”; Ligji nr. 9136, datë 11.09.2003; Ligji nr. 7703, datë 11.03.1993 “Për sigurimet shoqërore”.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 5091, datë 18.05.2012, ka vendosur: -Pranimin pjesërisht të padisë së paditësit Robert Martini. -Detyrimin e palës së paditur Ministria e Punëve të Jashtme, t’i paguajë paditësit Robert Martini: -dëmshpërblimin për moszbatimin e procedurës për zgjidhjen e kontratës së punës të barabartë me pagën e 2 muajve punë, -dëmshpërblimin për mosrespektim të afateve të njoftimit të barabartë me pagën e 2 muajve punë, -dëmshpërblimin për zgjidhjen e menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës të barabartë me 12 paga mujore, -shpërblimin për vjetërsi të barabartë me 2 paga mujore, -pagesën për pushimet vjetore të pakryera për tre vitet e fundit 2008 - 2011, -kontributin shëndetësor dhe shoqëror për periudhën tetor 2010 – 10.02.2011, duke i llogaritur detyrimet me pagën mujore që ai ka përfutur në momentin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës 500 Euro. -Pranimin pjesërisht të padisë së paditëses Bubulina Martini. -Detyrimin e palës së paditur Ministria e Punëve të Jashtme, t’i paguajë paditëses Bubulina Martini: -dëmshpërblimin për moszbatimin e procedurës për zgjidhjen e kontratës së punës të barabartë me pagën e 2 muajve punë, -dëmshpërblimin për mosrespektim të afateve të njoftimit të barabartë me pagën e 2 muajve pune, -dëmshpërblimin për zgjidhjen e menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës të barabartë me 10 paga mujore, -shpërblimin për vjetërsi të barabartë me 1.5 muaj pagë, -pagesën për pushimet vjetore të pakryera për tre vitet e fundit 2008 – 2011, -kontributin shëndetësor dhe shoqëror për periudhën 15.11.2007 – 10.02.2011, duke i llogaritur detyrimet me pagën mujore që ajo ka përfutur në momentin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës 190 Euro. -Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të kërimit. -Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen pales së paditur.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 695, datë 20.03.2013, ka vendosur: -Lënie në fuqi të vendimit nr. 5091, datë 18.05.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kundër këtij vendimi, ka paraqitur recurs pala e paditur Ministris e Punëve të Jashtëme, e cila kërkon ndryshimin e vendimit nr. 695, datë 20.03.2013 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe të vendimit nr. 5091, datë 18.05.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe rrëzimin e padisë si të pambështetur në prova dhe në ligj.

V E N D O S I

Ndryshimin e vendimit nr. 695, datë 20.03.2013 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe vendimit nr. 5091, datë 18.05.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe rrëzimin e kërkesë padisë.

Tiranë më 29.03.2016

Nr. 11241-02861-00-2013 i Regj. Themeltar
Nr. 00 - 2016 - 1491 i Vendimit (192)